



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.98/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur ankesën e Subjektit Politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër Subjektit Politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik Srpska Lista ZL.Anr.98/2025, e datës 02.10.2025, paraqitur kundër Subjektit politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, në të cilën pretendohet se aktivistët e subjektit politik Lista Serbe, në rrjetin social Facebook, më saktësisht në profilin zyrtar të Subjektit Politik GI Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, kanë vënë re se për qëllime zgjedhore është publikuar fotografia e Nenad Rašić-it, kryetarit të këtij subjekti politik, me një të mitur, me çka është shkelur Rregullorja Zgjedhore nr. 7/2024, pikërisht neni 5, paragrafi 3, i cili ndalon pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatën zgjedhore. Në fotografi shihet qartë se bëhet fjalë për një person të mitur, pa fytyrë të fshehur, dhe vetë imazhi përdoret për promovimin e subjektit politik të përmendur. Në foton e bashkangjitur në ankesë si provë, nuk është i pranishëm prind i personit të mitur/fëmijës në fjalë.

Andaj kan; kërkouar nga PZAP-i që ankesën të miraton si të bazuar, të konstatoj se GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak ka shkelur Rregulloren Zgjedhore nr. 7/2024 dhe ti shqiptoj sanksion të përshtatshëm për shkak të shkeljes së Rregullores së lartcekur.

PZAP-i më datë 02.10.2025 subjektit politik, GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, i ka dërguar Kërkesë për përgjigje në ankesë, mirëpo i njëjti në afatin e paraparë deri më 03.10.2025 në ora 10:00 nuk është përgjigjur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Srpska Lista janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore*". *Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve*, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Srpska Lista, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që kryetari i subjektit politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, Nenad Rašić, shihet me një të mitur në fotografi, mirëpo në këtë rast fëmija është në prani të prindërve të tij që do të thotë se ka pasur pëlqimin e tyre, mirëpo përkundë këtyre rrethanave i njëjti nuk mbanë ndonjë shenjë identifikuese të subjektit të tij politik dhe se këto veprime nuk kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore, pasi që i njëjti ka qenë duke kryer aktivitetin e tij si zyrtar i Ministrisë. Në këtë rast subjekti politik Srpska Lista, nuk ka ofruar dëshmi, andaj dhe në mungesë të provave nuk mund të vërtetohen pretendimet e tilla, për çka Paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*".

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.98/2025 me datë 03.10.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, par. 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.